

DORACAK PER KURRIKULËN



Ky material është krijuar në kuadër të projektit:
“Drejt praktikave gjithëpërfshirëse dhe mbështetjes së sjelljes
pozitive në arsim dhe punë sociale”,
i financuar nga Fondi i Visegradit

Alina Ivanenko¹, Alla Moskalets², Kateryna Ivanova², Lucia Mikurčíková³, Ivana Trellova³,
Evgenia Panichevska⁴, Teuta Ramadani Rasimi⁵, Monika Suchowejska⁶, Nataliia
Zavarova⁷.

¹Donbas State Pedagogical University

²Masaryk University

³University of Presov

⁴NTUU Igor Sikorsky Kyiv Polytechnic
Institute

⁵University of Tetova

⁶SWPS University of Social Sciences and
Humanities

⁷Odessa Regional Academy of In-Service
Education

• Visegrad Fund
• •



MUNI PED Institute for Research in Inclusive Education



MUNI PED Institute for Research in Inclusive Education



Tabela e përmbajtjes

Hyrje	4
Përmbledhje e shkurtër e projektit	4
Përmbajtja e doracakut	5
Hyrje në kurrikulë	7
Moduli I: Konceptet dhe parimet e analizës së sjelljes	8
Aktivitete të sugjeruara	9
Rekomandime të përgjithshme për trajnuesit	10
Përshtatja në kontekst lokal	10
Përmbajtja, materiale dhe tema shtesë	10
Moduli II: Bazat e vlerësimit dhe metodat e ndryshimit të sjelljes	12
Aktivitete të sugjeruara	13
Rekomandime të përgjithshme për trajnuesit	14
Përshtatja në kontekst lokal	14
Përmbajtja, materiale dhe tema shtesë	14
Moduli III: Sjellja verbale	16
Aktivitete të sugjeruara	17
Rekomandime të përgjithshme për trajnuesit	17
Përshtatja në kontekst lokal	18
Përmbajtja, materiale dhe tema shtesë	18
Moduli IV: Matjet e sjelljes	20
Aktivitete të sugjeruara	21
Rekomandime të përgjithshme për trajnuesit	22
Përshtatja në kontekst lokal	22
Përmbajtja, materiale dhe tema shtesë	22
Moduli V: Bazat e ndërhyrjes dhe zbatimit të programeve ABA I	24
Aktivitete të sugjeruara	25
Rekomandime të përgjithshme për trajnuesit	26
Përshtatja në kontekst lokal	26
Përmbajtja, materiale dhe tema shtesë	26
Moduli VI: Bazat e ndërhyrjes dhe zbatimit të programeve ABA II	28
Aktivitete të sugjeruara	29
Rekomandime të përgjithshme për trajnuesit	30

Përshtatja në kontekst lokal	30
Përmbajtja, materiale dhe tema shtesë	30
Moduli VII: Sjelljet sfiduese	32
Aktivitete të sugjeruara	33
Rekomandime të përgjithshme për trajnuesit	34
Përshtatja në kontekst lokal	34
Përmbajtja, materiale dhe tema shtesë	34
Moduli VIII: Parimet profesionale dhe etike për ushtrimin e ABA-së	36
Aktivitete të sugjeruara	37
Rekomandime të përgjithshme për trajnuesit	37
Përshtatja në kontekst lokal	38
Përmbajtja, materiale dhe tema shtesë	38
Moduli IX: Përfshirja dhe mbështetja në mjediset arsimore dhe të punës sociale	40
Aktivitete të sugjeruara	41
Rekomandime të përgjithshme për trajnuesit	42
Përshtatja në kontekst lokal	42
Përmbajtja, materiale dhe tema shtesë	42
Lista e vjegëzave të videove dhe podkasteve	44
Moduli I	44
Moduli II	44
Moduli III	45
Moduli IV	46
Moduli V	46
Moduli VI	47
Moduli VII	47
Moduli VIII	48
Moduli IX	48

Hyrje

Përmbledhje e shkurtër e projektit

Mirë se vini në doracakun për zbatimin e kurrikulës së projektit V+.

Projekti "Drejt praktikave gjithëpërfshirëse dhe mbështetjes së sjelljes pozitive në arsim dhe punë sociale" është iniciativa e bashkëpunimit në aspektin arsimor midis partnerëve nga vendet e Visegradit (V+). Qëllimi i projektit është të promovojë praktikat gjithëpërfshirëse dhe të përhapë njohuritë për analizën e sjelljes së aplikuar (ABA), për të mbështetur zbatimin e praktikave të mbështetjes me anë të sjelljes pozitive në të gjitha mjediset e shërbimeve arsimore dhe sociale, duke ofruar trajnime për mbështetje të profesionistëve, si: mësues, psikologë, punonjës socialë, si gjatë përgatitjes universitare ashtu edhe për ata që tashmë janë në punë.

Kjo iniciativë bashkoi gjashtë institucione të arsimit të lartë nga Republika Çeke, Sllovakia, Polonia, Maqedonia e Veriut dhe Ukraina, secila duke kontribuar me ekspertizë të veçantë në edukim special, psikologji, punë sociale ose analizën e sjelljes së aplikuar. Projekti adreson nevojën për qasje më të gjerë në njohuritë për ABA-në duke krijuar dhe përkthyer materiale edukative në gjuhët përkatëse të vendeve partnere dhe duke i ofruar të njëjtat edhe në formatin online. Këto burime shërbejnë si bazë për trajnimin e profesionistëve vendas dhe nxisin një kuptim të përbashkët për strategjitë efektive gjithëpërfshirëse.

Objektivat kyçe të projektit janë:

1. Vlerësimi i nivelit aktual të njohurive të profesionistëve në vendet partnere në lidhje me strategjitë e analizës së aplikuar të sjelljes, për mbështetjen e sjelljes pozitive.
2. Zhvillimi i kurrikulës në bazë të praktikave më të mira nga vendet partnere.
3. Krijimi i materialeve edukative për trajnimin në formatin online me qëllim që të arrihet te një audiencë më e gjerë.
4. Trajnimi i profesionistëve të vendeve partnere që të pajisen me njohuri bazë mbi ABA-në dhe praktikat ndërkombëtare.



5. Promovimi i ndërgjegjësimi dhe zbatimit praktik të strategjive ABA për të inkurajuar sjelljen pozitive dhe gjithëpërfshirëse në mjedise të ndryshme.

Projekti u krijua me idenë që të rritet qasja e informacionit për ABA-në dhe zhvillimin e mbështetjes së sjelljes. Duke ofruar burime të përkthyer dhe të qasshme për trajnim, projekti i fuqizon edukatorët, psikologët, punonjësit socialë dhe profesionistët e tjerë në mbështetje efektive ndaj individëve me nevoja të ndryshme.

Përmbajtja e doracakut

Ky doracak ofron udhëzime për mënyrën e zbatimit të kurrikulës së projektit dhe do të shërbejë si udhërrëfyes për materialet e kursit.

Kurrikula V+ është e ndarë në 9 module, secili i fokusuar në një aspekt kyç të analizës së sjelljes së aplikuar (ABA) dhe gjithëpërfshirjes, brenda konteksteve të arsimit dhe punës sociale. Modulet e mësimi elektronik (e-mësimi) janë krijuar për të qenë fleksibile dhe të qasshme për mësim asinkron, por nëse është e nevojshme, edhe për trajnim me prezencë fizike.

Kriteret për trajnerët:

- Diplomë universitare në psikologji, edukim special, mësim klasor ose punë sociale.

Çdo modul përfshin:

- Video elektronike të prezantimit të mësimi
- Prezantime në PPT
- Fletë pune për pjesëmarrësit (shënime të udhëzuara)
- Aktivitete të sugjeruara
- Kuiz me pyetje

Moduli I	Konceptet dhe parimet e analizës së sjelljes Përkufizimet dhe karakteristikat e ABA-së; sfondi historik; kuptimi i sjelljes përmes modelit ABC (Parandodhësi– Sjellja – Pasoja); kuptimi bazë i përforcimit dhe ndëshkimit; shuarja (extinction); operacionet motivuese.
Moduli II	Bazat e vlerësimit dhe metodat e ndryshimit të sjelljes Identifikimi i përforcuesve efektivë; zhvillimi i vlerësimeve të preferencave; hyrje në skemat e përforcimit; përmbledhje e metodave për vlerësimin e aftësive.
Moduli III	Sjellja verbale Bazat e komunikimit (sjellja verbale) nga perspektiva e ABA-së; operantët verbalë dhe joverbalë; modeli ABC në komunikim; kërkesa, emërtimi ekoik, bashkëbisedimi dhe repertorët e reagimit të atij që dëgjon; protokollet e të nxënësve për nxënës verbalë dhe joverbalë.
Moduli IV	Matjet e sjelljes Përkufizimi i sjelljes me nocione të vëzhgueshme dhe të matshme; metoda të vazhdueshme dhe me ndërprerje të mbledhjes së të dhënave; regjistrimi i prodhimit të përhershëm; përgatitja për mbledhjen e të dhënave; mbledhja e të dhënave gjatë nxënies së aftësive dhe sjelljeve sfiduese; analiza vizuale.
Moduli V	Zbatimi i programit ABA I Zhvillimi dhe përgatitja e planeve individuale të mësimi; strategjitë e mësimi natyral; mësimi me prova diskrete (MPD); të nxënësve pa gabime; përdorimi i nxitjeve dhe zbehja e tyre; skemat e përforcimit; sistemet e shpërblimit; kontratat e sjelljes.
Moduli VI	Zbatimi i programit ABA II Analiza e detyrave dhe zinxhirit; formësimi i sjelljeve të reja; trajnimi i diskriminimit; transferimi i kontrollit të stimulit; nxitja e përgjithësimi dhe mirëmbajtjes së aftësive të mësuara.
Moduli VII	Reduktimi i sjelljeve sfiduese Zhvillimi i vlerësimeve të sjelljes funksionale (VSF); identifikimi i funksioneve të sjelljes; hartimi i planeve të ndërhyrjes në sjellje (PNS); ndërhyrjet të parandodhësit; strategjitë e përforcimit diferencial; shuarja; procedurat e reduktimit; çështjet etike.
Moduli VIII	Parimet profesionale dhe etike për praktikën e ABA-së Parimet e sjelljes profesionale; marrja e vendimeve etike; dokumentimi dhe mbrojtja e të dhënave; shpërndarja dhe komunikimi i përshtatshëm i informacionit brenda konteksteve profesionale.
Moduli IX	Gjithëpërfshirja dhe mbështetja në mjediset e arsimit dhe të punës sociale Përkufizimi dhe promovimi i praktikave gjithëpërfshirëse; rolet profesionale dhe bashkëpunimi; konsideratat etike në mjediset gjithëpërfshirëse; modelet e aftësisë së kufizuar (mjekësor, funksional, social); përshkrimi i çrregullimeve zhvillimore, neurologjike dhe mendore; sistemet mbështetëse; shembuj nga vendet partnere.

Hyrje në kurrikulë

Kurrikula V+ është e krijuar për mësim asinkron, por mund të përshtatet edhe për edukim me prezencë fizike ose në formë të kombinuar (hibride).

Çdo modul përmban blloqe të mësimave, me videoprezantim të mësimi, prezantime në PPT, shënime të udhëzuara, kuiz dhe aktivitete opsionale.

Fasilitatorët mund të caktojnë pjesë për studim të pavarur nga ana e pjesëmarrësve ose të organizojnë sesione për diskutim për të përforcuar përmbajtjen e mësimave.



Moduli I: Konceptet dhe parimet e analizës së sjelljes

Korniza kohore:	Mësimi i parë	30 min
	Mësimi i dytë	30 min
	Kuiz	10 deri 15 min
	Materiale shtesë	2 orë
	Diskutimi i sugjeruar	30 deri 60 min
Qëllimet:	Të njihen pjesëmarrësit me konceptet themelore të analizës së sjelljes së aplikuar (ABA) dhe rëndësinë e saj në fusha të ndryshme profesionale. Në përfundim të këtij moduli, pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të përkufizojnë dhe të dallojnë parimet kryesore të sjelljes dhe të shpjegojnë modelin ABC si një kornizë për analizimin e sjelljes.	
Temat që përfshihen:	• Përkufizimi dhe karakteristikat e ABA-së • Sfondi historik i shkencës së sjelljes (Pavlov, Watson, Skinner) • Çfarë është sjellja (e vëzhgueshme, e matshme, funksionale) • Modeli ABC (Parandodhësi – Sjellja – Pasoja) • Përforcimi pozitiv dhe negativ • Ndëshkimi pozitiv dhe negativ • Shuarja • Operacionet motivuese (MO, EO, AO)	
Parapërgatitja:	• Shikoni dhe dëgjoni videoprezantimet e mësimave. • Rishikoni prezantimet e mësimave të parë dhe të dytë të modulit I. • Printoni/shpërndani shënimet e udhëzuara. • Përgatitni fletë pune me shembuj të modelit ABC dhe llojeve të përforcimit.	
Materialin e gjeni tek:	is.muni.cz hyrje në ABA në:	

EN (gjuhën angleze), CZ (gjuhën çeke),
PL (gjuhën polake), UA (gjuhën ukrainase),
MK (gjuhën maqedonase), AL (gjuhën shqipe).

Kërkesa teknike: Lidhje e qëndrueshme e internetit për riprodhimin e videove.

Aktivitete të sugjeruara

Për trajnim asinkron:

Ofrojuni pjesëmarrësve qasje në videomësimet, prezantimet në PPT dhe shënimet e udhëzuara.

Opsionale. Ofrojuni pyetje për reflektim (shih më poshtë) që mund t'i dorëzojnë me shkrim.

Për trajnim hibrid ose me prezencë fizike:

Diskutim në grup. Mbani sesione të drejtpërdrejta ose të sinkronizuara online për konceptet e ABA-së, çështjet etike dhe zbatimet në situata reale.

Sesioni pyetje-përgjigje (Q&A).

Fletë pune ABC. Shpërndani fletë pune me skenar të modelit ABC të përshtatur sipas kulturës/kontekstit.

Luajtja e roleve ose ushtrimet me video. Përdorni videoshembuj nga YouTube ose luani role me prezencë fizike për t'iu mundësuar pjesëmarrësve të identifikojnë sekuencat A–B–C.

Mini kuiz. Përdorni ose përshtatni një test me 10 pyetje me zgjedhje të shumëfishta për të rishikuar terminologjinë kryesore.

Shembuj të pyetjeve për reflektim/diskutim:

Cili është dallimi midis përforcuesit dhe ryshfetit?

Si mund të çojë përforcimi në mënyrë të paqëllimshme në sjellje problematike?

Cilat dilema etike mund të lindin kur zbatohet ndëshkimi?

Përshkruani një rast tek i cili mjedisi juaj e ka formuar sjelljen tuaj në mënyrë të paqëllimshme.

Rekomandime të përgjithshme për trajnuesit

Përdorni shembuj të njohur në aspektin kulturor për pjesëmarrësit, si nga: arsimi, puna sociale ose rutinat arsimore.

Theksoni zbatimet praktike të analizës ABC dhe parimeve të përforcimit.

Përshtatni lojën e roleve dhe diskutimet për të pasqyruar sfondin e pjesëmarrësve dhe grupet e synuara.

Ofroni shpesh mundësi për pjesëmarrje aktive (p.sh.: detyra/diskutime në grupe të vogla, mësim nga bashkëpjesëmarrësit).

Inkurajoni përdorimin e shënimeve të udhëzuara për të strukturuar të nxënit e pjesëmarrësve.

Përforconi kontributin e pjesëmarrësve duke përdorur lavdërime ose strategji të tjera të kushtëzuara të përforcimit.

Kontrolloni rregullisht kuptueshmërinë.

Përshtatja në kontekst lokal

Ofroni diskutime të përshtatura për reflektim dhe shembuj konkretë të cilët janë në përputhshmëri me sistemin kombëtar dhe strukturat e shërbimeve sociale.


Përmbajtja, materiale dhe tema shtesë

Libra



Cooper, J. O., Heron, T. E., & Heward, W. L. (2020). Applied Behavior Analysis (3rd ed.). Recommended Chapter: Chapter 2

Kearney, A. J. (2015). Understanding Applied Behavior Analysis: An Introduction to ABA for Parents, Teachers, and Other Professionals. Jessica Kingsley Publishers



Video

[Understanding Applied Behavior Analysis \(ABA\)](#) (YouTube; 15:09)

[What Are the ABC's of Behavior? Why is ABC Data Important?](#) (YouTube; 14:45)



Podkaste

[Episode 100 - The History of ABA w/ Dr. Gina Green](#) (ABA Inside Track; 1:30:44)

[Episode 111 - Behavior Analytic Language](#) (ABA Inside Track; 1:25:08)



Artikuj

Heward, W.L., Critchfield, T.S., Reed, D.D., Detrich, R., & Kimball, J.W. (2022). ABA from A to Z: Behavior science applied to 350 domains of socially significant behavior. *Perspectives on Behavior Science*, 45, 327-359. doi:10.1007/s40614-022-00336-z

Normand, M.P. & Kohn, C.S. (2013). Don't wag the dog: Extending the reach of applied behavior analysis. *The Behavior Analyst*, 36, 109-122. doi: 10.1007/BF03392294

Baer DM, Wolf MM, Risley T. Current dimensions of applied behavior analysis. *Journal of Applied Behavior Analysis*. 1968;1:91–97. doi: 10.1901/jaba.1968.1-91.

Moduli II: Bazat e vlerësimit dhe metodat e ndryshimit të sjelljes

Korniza kohore:	Mësimi i pare	30 min
	Kuiz	10 deri 15 min
	Materiale shitesë	2 orë
	Diskutimi i sugjeruar	30 deri 60 min
Qëllimet:	Të njihen pjesëmarrësit me procedurat e vlerësimit të sjelljes që ndihmojnë në identifikimin e përforcuesve efektivë dhe në udhëheqjen e zhvillimit të aftësive. Fokusi është te dallimi midis preferencës dhe përforcimit, përdorimi i mjeteve të përshtatshme të vlerësimit dhe te zbatimi i strategjive të personalizuar për ndryshimin e sjelljes.	
Temat që përfshihen:	• Rëndësia e përforcimit në të nxënë • Përforcuesit primarë kundrejt atyre sekondarë • Procesi i identifikimit të përforcuesve me dy hapa • Llojet e vlerësimeve të preferencave (intervistë, vëzhgim me prova) • Përforcuesi kundrejt preferencës • Oraret e përforcimit (CRF, RF, RN, IF, IN) • Përshkrimi i mjeteve të vlerësimit të aftësive: VB-MAPP, ABLLS-R, EFL, AFLS	
Parapërgatitja:	• Shikoni dhe dëgjoni videoprezantimin e mësimit. • Rishikoni prezantimin në PPT. • Printoni/shpërndani shënimet e udhëzuara. • Printoni dhe shpërndani shembuj të vlerësimit të preferencave (SV, SÇ, SSHPZ, SSHMZ) • Përdorni videot e rekomanduara në YouTube që demonstrojnë vlerësimet me prova (trial-based assessments).	
Materialin e gjeni tek:	is.muni.cz hyrje në ABA në: EN (gjuhën angleze), CZ (gjuhën çeke), PL (gjuhën polake), UA (gjuhën ukrainase), MK (gjuhën maqedonase), AL (gjuhën shqipe).	

Kërkesa teknike: Lidhje e qëndrueshme e internetit për riprodhimin e videove.

Aktivitete të sugjeruara

Për trajnim asinkron:

Ofrojuni pjesëmarrësve qasje në videomësimet, prezantimet në PPT dhe shënimet e udhëzuara.

Caktojuni shikimin e videove për vlerësimin e preferencave dhe kërkonit që të reflektojnë mbi atë që kanë parë.

Opsionale. Kërkonit nga pjesëmarrësit të shkruajnë një skenar të shkurtër në të cilin një objekt i preferuar nuk ka qenë përforcues efektiv.

Për trajnim hibrid ose me prezencë fizike:

Vlerësim i simuluar i preferencave. Çiftëzoni pjesëmarrësit që të realizojnë vlerësim të preferencave.

Sesioni pyetje-përgjigje (Q&A).

Detyrë për diskutim. Krahasoni shkurtimisht se si shfaqen oraret e përforcimit në mënyrë natyrale në klasë dhe në mjediset e terapisë (p.sh.: përdorimi i tokenëve, pushimet, lavdërimet). Më pas diskutoni pse vlerësimet e preferencave janë thelbësore për përshtatjen e ndërhyrjeve efektive, etike dhe motivuese.

Loja me role për skemat e përforcimit. Çiftëzoni pjesëmarrësit për një ushtrim të shkurtër ku do të provojnë skema të ndryshme të përforcimit në praktikë.

Shembuj të pyetjeve për reflektim/diskutim:

Cilët faktorë mund të ndikojnë që një objekt i preferuar të mos funksionojë si përforcues?

Pse është e rëndësishme të rivlerësohen shpesh preferencat e përforcimit?

Në çfarë mënyre ndikojnë motivimi dhe oraret e përforcimit në nxënien e aftësive?

Si siguroheni që vlerësimet e aftësive të pasqyrojnë edhe saktësinë, edhe dinjitetin e nxënësit?

Rekomandime të përgjithshme për trajnuesit

Ofroni shumë shembuj (të shkollës, qendrave, të mjedisit në shtëpi) kur prezantoni modelet e vlerësimit të preferencës.

Theksoni zbatimin praktik për të nxitur ruajtjen e procedurave.

Diskutoni pengesat gjatë vlerësimit në situata reale (p.sh.: koha e kufizuar, mosbashkëpunimi, nevojat shqisore).

Jepuni kohë për reflektim pjesëmarrësve për vlerësimin e simuluar.

Përshtatja në kontekst lokal

Inkurajoni pjesëmarrësit të krijojnë një listë të përforcuesve sipas kontekstit specifik të bazuar në mjedisin lokal (p.sh. shkolla).

Diskutoni praktikat e secilit shtet në lidhje me rregulloret për pajtim dhe vlerësim.

Përdorni shembuj/formate të vlerësimeve që janë relevante për shtetin përkatës (p.sh.: vlerësimet e edukimit parashkollor të Çekisë krahasuar me vlerësimet e edukimit klasor të Polonisë).

Përmbajtja, materiale dhe tema shtesë

Libra



Cooper, J. O., Heron, T. E., & Heward, W. L. (2020). Applied Behavior Analysis (3rd ed.). Recommended Chapter: Chapter

Sundberg, M. L. (2008). VB-MAPP verbal behavior milestones assessment and placement program. Concord, CA: AVB Press.

McGreevy, P., Fry, T., & Cornwall, C. (2012). Essential for Living.

Partington, J. W. (2006). (ABLLS-R) Assessment of Basic Language and Learning Skills – Revised. Behavior Analysts, Inc.

Video



Institute for Research
in Inclusive Education



SWPS
University



[Paired Stimulus Preference Assessment](#) (YouTube; 4:26)

[Preference Assessment: Free Operant Observation](#) (YouTube; 5:16)

[SINGLE STIMULUS \(Preference Assessment\)](#) (YouTube; 3:48)

[Preference Assessment – Trial-Based](#) (YouTube; 4:22)

[Preference Assessment with Toys: Multiple Stimulus without Replacement \(MSWO\)](#) (YouTube; 3:43)

[Variable Ratio See Do](#) (YouTube; 0:32)

[Fixed Interval-Free-Do Stack Blocks](#) (YouTube; 0:41)

[Fixed Ratio See Do](#) (YouTube; 0:24)

[Variable Interval 3 7seconds Free Do Stack Blocks](#) (YouTube; 0:42)



Podkaste

[Episode 9 - Choice](#) (ABA Inside Track; 1:20:26)

[Advanced Preference Assessment](#) (ABA Inside Track; 1:23:08)

[Episode 47 - Social Reinforcer Assessment](#) (ABA Inside Track; 1:14:23)



Artikuj

Fisher, W.W., Thompson, R.H., Piazza, C.C., Crosland, K., & Gotjen, D. (1997). On the relative reinforcing effects of choice and differential consequences. *Journal of Applied Behavior Analysis*, 30, 423-438. doi:10.1901/jaba.197.30-423

McKerchar, P. M., & Thompson, R. H. (2004). A Descriptive Analysis of Potential Reinforcement Contingencies in the Preschool Classroom. *Journal of Applied Behavior Analysis*, 37(4), 431–444. <https://doi.org/10.1901/jaba.2004.37-431>

Murphy, H. A., Hutchison, J. M., & Bailey, J. S. (1983). Behavioral School Psychology Goes Outdoors: The Effect of Organized Games on Playground Aggression. *Journal of Applied Behavior Analysis*, 16(1), 29–35. <https://doi.org/10.1901/jaba.1983.16-29>

Moduli III: Sjellja verbale

Korniza kohore:	Mësimi i pare	30 min
	Mësimi i dytë	30 min
	Kuiz	10 deri 15 min
	Materiale shitesë	2 orë
	Diskutimi i sugjeruar	30 deri 60 min
Qëllimet:	Të njihen pjesëmarrësit me analizën e sjelljes verbale sipas B. F. Skinner, përfshirë aplikimin e saj gjatë vlerësimeve dhe intervenimeve tek individët me nevoja të veçanta të komunikimit dhe zhvillimit. Moduli gjithashtu ka për qëllim të zhvillojë njohuri praktike për nxënien dhe vlerësimin e operantëve verbalë.	
Temat që përfshihen:	• Përkufizimi dhe karakteristikat e sjelljes verbale • Tiparet funksionale të gjuhës kundrejt atyre formale • Sjellja e folësit kundrejt sjelljes së dëgjuesit • Operantët verbalë: kërkesa, emërtimi, ekoiku, bashkëbisedimi, kodiku, imitimi • Diskriminimi i dëgjuesit dhe episodet verbale • Vlerësimi i operantëve verbalë • Mësimi i sjelljes verbale (MMN dhe MPD)	
Parapërgatitja:	• Shikoni dhe dëgjoni videoprezantimet e mësimave. • Rishikoni prezantimet e mësimit të parë dhe të dytë të modulit III. • Printoni/shpërndani shënimet e udhëzuara. • Përgatitni karta për memorie dhe mjete vizuale.	
Materialin e gjeni tek:	is.muni.cz hyrje në ABA në: EN (gjuhën angleze), CZ (gjuhën çeke), PL (gjuhën polake), UA (gjuhën ukrainase), MK (gjuhën maqedonase), AL (gjuhën shqipe).	
Kërkesa teknike:	Lidhje e qëndrueshme e internetit për riprodhimin e videove.	

Aktivitete të sugjeruara

Për trajnim asinkron:

Ofrojuni pjesëmarrësve qasje në videomësimet, prezantimet në PPT dhe shënimet e udhëzuara.

Jepuni fletë pune për të krahasuar operantët verbalë.

Përfshini shembuj të rasteve për identifikimin e operantëve të pavarur.

Për trajnim hibrid ose me prezencë fizike:

Loja e renditjes së operantëve. Përgatitni karta për memorie ose mjete vizuale ku pjesëmarrësit duhet t'i radhisin operantët sipas formës dhe funksionit.

Detyrë me planifikim. Udhëzoni pjesëmarrësit të zhvillojnë një shembull të planifikimit për mësim duke përdorur MMN dhe MPD.

Shpjegim i vlerësimit. Shfaqni video dhe lehtësoni kodimin e operantëve.

Fascilitoni diskutimin. Nxisni analizën e metodave të mësimdhënies për sjelljen verbale në mjedise të strukturuar kundrejt atyre natyrore.

Shembuj të pyetjeve për reflektim/diskutim:

Pse është e rëndësishme të bëhet dallimi mes kërkesës dhe emërtimit?

Si ndikon motivimi në sjelljen verbale?

Si mund të formësohet sjellja e dëgjuesit paralelisht me sjelljen e folësit?

Rekomandime të përgjithshme për trajnuesit

Jepni shembuj nga jeta reale për secilin operant (p.sh.: nga klasa, nga shtëpia).

Theksoni procedurat e mësimi që nxisin pavarësinë dhe zvogëlojnë varësinë nga nxitjet.

Modeloni dallimin midis tipareve formale dhe funksionale duke përdorur mjete vizuale.

Përfshini aktivitete të fokusuara te pjesëmarrësit për të thelluar kuptimin e dinamikës folës–dëgjues.

Përshtatja në kontekst lokal

Përdorni shembuj të sjelljes verbale të njohur në aspektin kulturor (p.sh.: përshtendetje, kërkesa, emërtimi i objekteve të njohura).

Jepni shembuj të intervenimeve me MMN dhe MPD në shkollë kundrejt mjediseve në shtëpi duke u bazuar në sistemin lokal dhe mundësitë e bashkëpunimit.

Përmbajtja, materiale dhe tema shtesë

Libra




Cooper, J. O., Heron, T. E., & Heward, W. L. (2020). Applied Behavior Analysis (3rd ed.).

Rieske, R. D. (Ed.). (2019). Handbook of Interdisciplinary Treatments for Autism Spectrum Disorder. Springer. (Autism and Child Psychopathology Series)

Bruinsma, Y., Minjarez, M. B., Schreibman, L., & Stahmer, A. C. (Eds.). (2020). Naturalistic Developmental Behavioral Interventions for Autism Spectrum Disorder. Baltimore, MD: Paul H. Brookes Publishing Co.

Video



[Ch 25 Verbal Behavior](#) (YouTube; 10:15)

[DTT and NET](#) (YouTube; 3:34)

Podkaste



[Episode 28 - FCT](#) (ABA Inside Track; 1:10:32)

[Episode 22 - AAC](#) (ABA Inside Track; 1:14:32)

[Episode 242 - Mand Training](#) (ABA Inside Track; 1:19:57)

Artikuj



Skinner, B. F. (1992, 2014) Verbal Behavior. Prentice-Hall, Inc., ISBN: 978-0-9899839-0-7;

https://www.bfskinner.org/wp-content/uploads/2014/05/2014_05_P_003.pdf

Dixon, M. R., Peach, J., Daar, J. H., Penrod, Cindy. (2017) Teaching complex verbal operants to children with autism and establishing generalization using the peak curriculum. Journal of Applied Behavior Analysis, <https://onlinelibrary.wiley.com/doi/full/10.1002/jaba.373>

Bondy, A., Tincani, M. & Frost, L. Multiply controlled verbal operants: An analysis and extension to the picture exchange communication system. BEHAV ANALYST 27, 247–261 (2004). <https://doi.org/10.1007/BF03393184>

Fisher, W.W., Rodriguez, N.M., & Owen, T.M. (2013). Functional assessment and treatment of perseverative speech about restricted topics in an adolescent with Asperger syndrome. Journal of Applied Behavior Analysis, 46, 307-311. Doi: 10.1002/jaba.19

Moduli IV: Matjet e sjelljes

Korniza kohore:	Mësimi i pare	30 min
	Mësimi i dytë	30 min
	Kuiz	10 deri 15 min
	Materiale shtesë	2 orë
	Diskutimi i sugjeruar	30 deri 60 min
Qëllimet:	Të njihen pjesëmarrësit me konceptet themelore dhe mjetet për matjen e sjelljes në mjedise të zbatuara. Moduli fokusohet në përkufizimet operacionale, sistemet e matjes së vazhdueshme dhe me ndërprerje, si dhe në përdorimin e analizës vizuale.	
Temat që përfshihen:	• Përkufizimi i sjelljes së vëzhgueshme dhe të matshme • Matja e vazhdueshme: frekuenca, kohëzgjatja, latenca, intensiteti • Matja me ndërprerje: interval i plotë, interval i pjesshëm, i mostrës momentale • Matja e produktit të përhershëm • Krijimi i fletës së të dhënave • Grafikimi dhe analiza vizuale e të dhënave (p.sh.: grafikë linearë, me shirita, kumulativë)	
Parapërgatitja:	• Shikoni dhe dëgjoni videoprezantimet e mësimëve. • Rishikoni prezantimet e mësimit të parë dhe të dytë të modulit IV. • Printoni/shpërndani shënimet e udhëzuara. • Përgatitni shembuj për diskutim të sjelljeve që janë qartë të definuara dhe atyre jo shumë të qarta. • Printoni fletë të paplotësuar të të dhënave që të mund të ushtrojnë. • Rishikoni videot me demonstrime dhe shënoni kohën për diskutime ose ushtrime.	

	Përgatitni fletë pune të paplotësuar me grafikone të gatshme për t'i plotësuar.
Materialin e gjeni tek:	is.muni.cz hyrje në ABA në: EN (gjuhën angleze), CZ (gjuhën çeke), PL (gjuhën polake), UA (gjuhën ukrainase), MK (gjuhën maqedonase), AL (gjuhën shqipe).
Kërkesa teknike:	Lidhje e qëndrueshme e internetit për riprodhimin e videove.

Aktivitete të sugjeruara

Për trajnim asinkron:

Ofrojuni pjesëmarrësve qasje në videomësimet, prezantimet në PPT dhe shënimet e udhëzuara.

Caktojuni pjesëmarrësve detyrë që t'i rishkruajnë përkufizimet operacionale që janë të paqarta, duke i kthyer në përkufizime të formuluar qartë, të vëzhgueshme dhe të matshme.

Udhëzoni pjesëmarrësit të shikojnë videodemonstrime të përzgjedhura paraprakisht ku tregohen llojet e ndryshme të matjeve (p.sh.: frekuenca, intervali i pjesshëm, latenca).

Për trajnim hibrid ose me prezencë fizike:

Aktivitet për përkufizimin e sjelljes. Prezantoni emërtime të sjelljeve të dyshimta nga jeta e përditshme (p.sh.: kur je "i pasjellshëm", "i padëgjueshëm"). Udhëzoni grupet e vogla në hartimin e përkufizimeve operacionale.

Simulimi i matjes. Shfaqni një klip të shkurtër për vëzhgimin e sjelljes (ose krijoni një skenar real) dhe kërkonit që pjesëmarrësit të mbledhin të dhëna duke përdorur sisteme të ndryshme (sipas frekuencës, intervalit, kohëzgjatjes).

Punëtori për krijimin e grafikëve. Ofroni të dhëna të mbledhura nga skenarët e simuluar dhe kërkojuni pjesëmarrësve të krijojnë grafikë vizualë (AB, ABAB).

Detyrë për diskutim. Diskutoni përparësitë dhe mangësitë e metodave të matjes së vazhdueshme dhe me ndërprerje.

Shembuj të pyetjeve për reflektim/diskutim:

Pse është e rëndësishme të definohet sjellja në mënyrë të qartë dhe objektive?

Në cilat raste matjet me ndërprerje janë më praktike sesa matjet e vazhdueshme?

Si ndikon përzgjedhja e metodës së matjes në interpretimin e të dhënave?

Cilat janë pikat e forta dhe kufizimet e matjeve të produktit të përhershëm?

Rekomandime të përgjithshme për trajnuesit

Përdorni shembuj të sjelljes relevante për kontekstin kulturor.

Theksoni saktësinë dhe qëndrueshmërinë në mbledhjen e të dhënave.

Përforconi rëndësinë e marrëveshjes mes vëzhguesve gjatë aktiviteteve në çifte.

Mbështetni rëndësinë e leximit të grafikëve dhe shkathtësive bazike për analizë vizuale.

Nxisni pjesëmarrësit të reflektojnë mbi preferencat e tyre kur definojnë një sjellje.

Përshtatja në kontekst lokal

Përdorni shembuj të vlerësimeve relevante për shtetin përkatës (p.sh.: vlerësime që përdoren në sistemin parashkollor në Çeki kundrejt vlerësimeve që përdoren në mësimin klasor në Poloni).

Ofroni diskutime për reflektim dhe shembuj që përputhen me sistemet kombëtare dhe strukturat e shërbimeve kombëtare.


Përmbajtja, materiale dhe tema shtesë

Libra



Cooper, J. O., Heron, T. E., & Heward, W. L. (2020). Applied Behavior Analysis (3rd ed.).

Cooper, J. O., Heron, T. E., & Heward, W. L. (2020). Applied Behavior Analysis (3rd ed.), supplemental resources and chapter visuals.



Video

Continuous Measurement (Rate, Frequency, Duration, IRT, Trials to Criterion, Percent of Occurrence) (YouTube; 15:46)

How to Measure Progress in ABA Programs (YouTube; 11:16)



Podkast

Episode 115 - Self-monitoring (ABA Inside Track; 1:15:32)



Artikuj

LeBlanc, L. A., Raetz, P. B., Sellers, T. P., & Carr, J. E. (2015). A proposed model for selecting measurement procedures. Behavior Analysis in Practice, 9(1), 77–83. doi:10.1007/s40617-015-0063-2

Moduli V: Bazat e ndërhyrjes dhe zbatimit të programeve ABA I

Korniza kohore:	Mësimi i pare	30 min
	Mësimi i dytë	30 min
	Kuiz	10 deri 15 min
	Materiale shitesë	2 orë
	Diskutimi i sugjeruar	30 deri 60 min
Qëllimet:	Të njihen pjesëmarrësit me procedurat themelore të përdorura në mësimdhënien e bazuar në ABA, duke përfshirë planifikimin për nxënien e aftësive, përdorimin e nxitjeve, zgjedhjen dhe zbehjen e skemave të përforcimit, si dhe zbatimin e sistemeve bazike motivuese. Ky modul i përgatit profesionistët që t'i zbatojnë metodat për mësimdhënien e aftësive me përpikëri dhe ndjeshmëri ndaj nevojave individuale të nxënësit.	
Temat që përfshihen:	• Përbërësit e planit për përvetësimin e aftësive • Mësimi në mjedis natyror dhe mësimdhënia intensive • Mësimdhënia pa gabime dhe procedurat e korrigjimit të gabimeve • Llojet e nxitjeve dhe zbehja e nxitjeve • Skemat e përforcimit (e vazhdueshme kundrejt me ndërprerje) • Sistemi i ekonomisë me shenja (token). • Kontratat e sjelljes	
Parapërgatitja:	• Shikoni dhe dëgjoni videoprezantimet e mësimave. • Rishikoni prezantimet e mësimin të parë dhe të dytë të modulit V. • Printoni/shpërndani shënimet e udhëzuara. • Përgatitni materiale si shembuj për modelimin e nxitjeve (vizuale, objekte etj.).	

	Përgatitni tabela të orareve dhe skemave për përforsim për demonstrim praktik.
Materialin e gjeni tek:	is.muni.cz hyrje në ABA në: EN (gjuhën angleze), CZ (gjuhën çeke), PL (gjuhën polake), UA (gjuhën ukrainase), MK (gjuhën maqedonase), AL (gjuhën shqipe).
Kërkesa teknike:	Lidhje e qëndrueshme e internetit për riprodhimin e videove.

Aktivitete të sugjeruara

Për trajnim asinkron:

Ofrojuni pjesëmarrësve qasje në videomësimet, prezantimet në PPT dhe shënimet e udhëzuara.

Pjesëmarrësit mund të përgatitin një shembull të shkurtër të planit për nxënien e aftësive duke përdorur qëllimet e sjelljes të dhëna paraprakisht.

Reflektim ndaj përparësive dhe mangësive të llojeve të ndryshme të nxitjeve dhe teknikave të shuarjes.

Për trajnim hibrid ose me prezencë fizike:

Simulim i nxitjes dhe shuarjes. Lojë rolesh me udhëzime duke përdorur nxitje fizike, verbale dhe vizuale. Rrotulloni pjesëmarrësit mes rolit të trajnuesit dhe fëmijës.

Planifikimi i përforsimit. Ushtrojuni shkrimin e deklaratave për dhënien e përforsimit.

Sistemi i token ekonomisë. Diskutoni mënyrën se si zhvillohet duke dhënë shembuj konkretë të sistemit të tokenëve, gjithashtu diskutoni rregullat e përdorimit dhe strategjitë e shuarjes.

Rishikimi i rastit. Rishikoni dhe diskutoni profilin e një fëmije duke shqyrtuar edhe hapat e mësimin, nxitjet dhe planin strategjik për përforsim.

Shembuj të pyetjeve për reflektim/diskutim:

Pse është e rëndësishme të zbehen nxitjet? Çfarë rreziqesh lindin nëse dështon ky proces?

Si mund të nxisë mësimdhënia në mjedis natyror përgjithësimin e aftësive?

Kur do ta përdornit përforcimin e vazhdueshëm kundrejt përforcimit me ndërprerje?
Çfarë e bën token ekonominë të jetë e suksesshme për grupmosha ose aftësi të ndryshme?

Si mund ta rrisin kontratat e sjelljes përgjegjësinë dhe motivimin e nxënësit?

Rekomandime të përgjithshme për trajnuesit

Theksoni qëllimin funksional të nxitjeve: ta mbështesin pavarësinë, jo kontrollin.

Përdorni përforcues të njohur në kontekstin kulturor dhe mësimor.

